



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/42

Datë: 27.10.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Ekstrakti i Procesverbalit dhe Transkripti nga mbledhja e 36 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohet Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e 37 elektronike\korresponduese e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/42
Datë: 27.10.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2021

1. Ndryshohet dhe plotësohet Programi Legjislativ për vitin 2021 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, si në vijim:

1.1. Ndryshohet afati i miratimit në Qeveri, i këtyre projektligjeve:

- 1.1.1 Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës (ZKM) afati i miratimit në Qeveri 13.12.2021;
- 1.1.2 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë (ZKM), afati i miratimit në Qeveri 07.12.2021;
- 1.1.3 Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-001 për Përfitim të ish Zyrtarëve të Lartë (ZKM), afati i miratimit në Qeveri 10.12.2021;
- 1.1.4 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-016 për Ushqimin (MBPZHR), afati i miratimit në Qeveri 30.11.2021;
- 1.1.5 Projektligji për Pyje (MBPZHR), afati i miratimit në Qeveri 30.11.2021;
- 1.1.6 Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi në kontekstin e aderimit në Bashkimin Evropian (MPJD), afati i miratimit në Qeveri 29.10.2021;
- 1.1.7 Projektligji për Diasporën (MPJD), afati i miratimit në Qeveri 26.11.2021;
- 1.1.8 Projektligji për Shërbimin e Jashtëm (MPJD), afati i miratimit në Qeveri 26.11.2021;
- 1.1.9 Projektligji për Zbatimin e Sanksioneve Financiare Ndërkombëtare të Shënjestruara (MPJD), afati i miratimit në Qeveri 12.11.2021;
- 1.1.10 Projektligji për Financat e Pushtetit Lokal (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 10.11.2021;
- 1.1.11 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 15.11.2021;
- 1.1.12 Projektligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 20.12.2021;
- 1.1.13 Projektligji për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare jo Bankare (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 20.12.2021;
- 1.1.14 Projektligji për Prokurim Publik (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 20.12.2021;

- 1.1.15 Projektligji për Partneritetin Publiko-Privat (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 20.12.2021;
- 1.1.16 Projektligji për Marrëveshjen e Bashkëfinancimit për Parkun Inovativ Trajnues në Prizren (ITP Prizren) në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) - (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 20.12.2021;
- 1.1.17 Projektligji për Marrëveshjen e Kredisë për Financim Shtesë për Projektin Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10, ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 30.11.2021;
- 1.1.18 Projekt Kodi Civil (MD), afati i miratimit në Qeveri 15.12.2021;
- 1.1.19 Projektligji për Pronën Publike (MD), afati i miratimit në Qeveri 15.12.2021;
- 1.1.20 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-023 për Personat e Zhdukur (MD), afati i miratimit në Qeveri 15.12.2021;
- 1.1.21 Projektligji për Sistemin Qendror të Evidencës Penale (MD), afati i miratimit në Qeveri 15.12.2021;
- 1.1.22 Projektligji për Avokaturën Shtetërore (MD), afati i miratimit në Qeveri 15.12.2021.

1.2. Shtohen në Programin Legjislativ për vitin 2021:


- 1.2.1. Projektligji për Aktet Juridike (ZKM), afati i miratimit në Qeveri 20.12.2021;
- 1.2.2. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 20.12.2021;
- 1.2.3. Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit për Projektin e "Reformës së Sistemit të Ndihmës Sociale në Kosovë" në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 20.12.2021;
- 1.2.4. Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës për pjesëmarrjen e Kosovës në programin Kornizë të Bashkimit Evropian për Kërkim dhe Inovacion – Horizon Evrope (MASHTI), afati i miratimit në Qeveri 30.10.2021;
- 1.2.5. Projektligji për Ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimi në mes të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, Kosovë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës për Programin e Shkëmbimit Akademik Fulbright (MASHTI), afati i miratimit në Qeveri 30.10.2021.

1.3. Tërhiqen nga Programi Legjislativ për vitin 2021:

- 1.3.1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social (MFPT);
- 1.3.2. Projektligji për Inspektoratin e Punës (MFPT);
- 1.3.3. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-216 mbi Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucione Financiare në Kosovë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-133 (MFPT);
- 1.3.4. Projektligji për Tatimin në të Ardhurat Personale (MFPT);
- 1.3.5. Projektligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (MFPT);
- 1.3.6. Projektligji për Kambialin dhe Premtim Pagesën (MFPT);

- 1.3.7. Projektligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (MFPT);
 - 1.3.8. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti (MFPT);
 - 1.3.9. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (MFPT);
 - 1.3.10. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-205 për Agjencinë e Punësimit (MFPT);
 - 1.3.11. Projektligji për Marrëveshjen e Kredisë për Projektin e Autostradës së Paqes, Segmenti Besi-Merdare, ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (MFPT);
 - 1.3.12. Projektligji për Marrëveshjen e Kredisë për Projektin e Autostradës së Paqes, Segmenti Besi-Merdare, ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Evropiane për Investime (MFPT);
 - 1.3.13. Projektligji për Ndihmën Shtetërore (MFPT);
 - 1.3.14. Projektligji për Pensionimin e Zyrtarëve Policorë (MFPT);
 - 1.3.15. Projektligji për Tregti të Brendshme (MINT).
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit që vendimin t'ia dërgojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
 3. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/42

Datë: 27.10.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/42

Datë: 27.10.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Tokën Ndërtimore.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/42

Datë: 27.10.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Produktet Biocide.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/42

Datë: 27.10.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja mbi pezullimin e shërbimeve komunale për mbledhjen e detyrimeve të papaguara të tatimit në pronë.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe institucionet tjera përkatëse për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/42

Datë: 27.10.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Vlerësimin Strategjik Mjedisor.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/42

Datë: 27.10.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 59 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e pesë (5) anëtarëve të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, i themeluar me Vendim të Qeverisë Nr. 06/21 më datë 28.07.2021.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidatët për pesë (5) anëtarë për Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale si në vijim:
 - 2.1. Midin Bojaxhiu;
 - 2.2. Qamil Suka;
 - 2.3. Gani Maliqi;
 - 2.4. Rrezarta Pushkolli - Makolli;
 - 2.5. Shaqir Rexhepi;
 - 2.6. Atifete Zuna;
 - 2.7. Ibush Luzha;
 - 2.8. Selvete Grajqevci- Pllana;
 - 2.9. Bexhat Bytyqi;
 - 2.10. Jahir Gashi;
 - 2.11. Gani Kastrati;
 - 2.12. Ibrahim Krasniqi;
 - 2.13. Behxhet Nimani;
 - 2.14. Zenel Sejfiqaj;
 - 2.15. Bajram Hoxha.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin dhe biografitë e kandidatëve të propozuar t'i procedojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/42

Datë: 27.10.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 15, 16, 17, 18 dhe 19 të Ligjit nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, të nenit 14 (1.9) të Rregullores Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Ndërmintor për Ujërat (në vijim KNU), si trup qeveritar koordinues dhe vendimmarrës që shqyrton çështjet sistemore të administrimit me ujëra, harmonizimin e nevojave dhe interesave të ndryshme, si dhe propozon masat për zhvillimin, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e resurseve dhe sistemit ujor të Kosovës, në këtë përbërje:


1.1. Kryeministri i Republikës së Kosovës,	Kryesues;
1.2. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve,	anëtar;
1.3. Ministria e Ekonomisë,	anëtare;
1.4. Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës,	anëtar;
1.5. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,	anëtar.
2. KNU ofron mendime dhe rekomandime për:
 - 2.1. Propozimin e nismave legislative që kanë të bëjnë me rregullimin e çështjeve nga fusha e ujërave në përgjithësi;
 - 2.2. Zbatimin e ligjeve dhe akteve tjera nënligjore që kanë të bëjnë me menaxhimin e ujërave;
 - 2.3. Hartimin dhe aprovimin e Strategjisë Shtetërore për Ujëra;
 - 2.4. Zgjedhjen e politikave financiare nga fusha e ujërave;
 - 2.5. Kryen edhe detyra tjera të përcaktuara me ligj.
3. Në takime të Këshillit, në varësi të temave mund të ftohen edhe ministra tjerë në rolin e kontribuuesit pa të drejtë vote.
4. Anëtarë të Këshillit pa të drejtë vote janë edhe Përfaqësuesi i Ambasadës Zvicerane (si koordinator i komunitetit të donatorëve në sektorin e ujërave) dhe përfaqësues (me rotacion) të donatorëve aktivë në sektorin e ujërave.
5. Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit është Sekretariat i KNU. ZPS do të kryej detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me rregulloren e punës së KNU.

6. Kryeministri dhe ministrat anëtarë të KNU do të përkrahen përmes këshilltarëve për Politika Ujore dhe për Rregullativë Ujore të deleguar nga Qeveria Zvicerane. Këshilltarët po ashtu do të përkrahin Sekretariatën, konkretisht ZPS në kryerjen e detyrave që lidhen me sektorin e ujërave.
7. Mjetet për shpenzimet e punës të KNU sigurohen nga Buxheti i vendit dhe nga përkrahja e donatorëve.
8. ZPS përgatit raporte, sipas udhëzimeve të KNU, të cilat prezantohen në Qeveri dhe Kuvend.
9. Obligohen të gjitha ministratë e linjës dhe palët në sektorin e ujërave të bashkëpunojnë dhe të mbështesin KNU dhe ZPS për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi.
10. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Qeverisë Nr. 07/31 i datës 21.09.2020.
11. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me qëllim të harmonizimit të aktit themelues të Këshillit Ndërmintor për Ujëra me vendimin nr. 08-V-005, të datës 22 mars 2021 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

I u d ë r g o h e t:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/42

Datë: 27.10.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, të nenin 13 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut dhe lirive themelore 2021-2025 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e Programit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut dhe lirive themelore 2021-2023.
2. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e Programit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit koordinon dhe monitoron zbatimin e Programit nga pika 1. e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/41

Datë: 27.10.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Financiar Nëntëmujor i vitit 2021 për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin sipas pikës 1. të këtij vendimi t'ia dorëzojë Kuvendit të Republikës së Kosovës, konform kërkesave të nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/42

Datë: 27.10.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 08/L-016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të ndryshuar dhe të plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Vendimin e Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet pagesa shtesë në vlerë të mbështetjes financiare prej 100 € (njëqind euro), për përfituesit e skemave pensionale për muajin Nëntor 2021, në kuadër të zbatimit të masës 3.2 - Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Të gjithë përfituesit e skemave pensionale përfitojnë shtesën sipas pikës 1. të këtij vendimi, të kufizuar në bazë të kriterëve si në vijim:
 - 2.1. Vlera e pensioneve aktuale (duke përfshirë shtesën aktuale) që përfiton një individ të mos të mos e kalojë shumën 500 € (pesëqind euro) në muajin Nëntor 2021; dhe
 - 2.2. Shtesa paguhet vetëm njëherë për një person.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ndahen mjete buxhetore në shumë prej 30,000,000 € (tridhjetë milionë euro), në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nën-programet, për aq sa aplikohen sipas pikës 1. dhe 2. të këtij vendimi, me kodet në vijim: 00100, 00200, 00300, 00400, 01100, 01200, 01400, 02200, 02500, 02700, 02900, 03000, 03100, në kategorinë "Subvencione dhe Transfere", sipas shumave të nevojshme bazuar në çekun mujor të pensioneve të kalkuluara sipas këtij vendimi. Në rast të nevojës, Thesari i Kosovës autorizohet paraprakisht, të bëjë alokimin e parakohshëm për të mbuluar përmbushjen e plotë të këtij vendimi, duke alokuar fondet përmes kodit 00098.
4. Mjetet e ndara sipas paragrafit 3. të këtij vendimi, merren nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike, nën-programi "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
5. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e plotë të këtij vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/42

Datë: 27.10.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 08/L-016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Vendimin e Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet dyfishimi i pagesës mbi vlerën bazë dhe shtesave të aprovuara me Vendimin e Qeverisë Nr. 06/24 të datës 11.08.2021, për përfituesit e skemës së ndihmës sociale për periudhën Nëntor - Dhjetor 2021, në kuadër të zbatimit të masës 3.2 - Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Për zbatimin e pikës 1. të këtij vendimi, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, do të bëjë alokimin dhe/apo rialokimin e mjeteve buxhetore sipas autorizimeve të përcaktuara në pikën 3. të Vendimit të Qeverisë Nr.13/19 të datës 14.07.2021.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e plotë të këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/42

Datë: 27.10.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 53, paragrafi 3 të Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Anulohet Vendimi Përfundimtar i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/115, i datës 17.12.2019 lidhur me shpronësimin për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i Autostradës Prishtinë - Pejë, Segmenti Kijevë - Klinë - Zahaq, zonat kadastrale Çabiq, Zabërgjë, Gllarevë, Gjurgjevik, Dresnik, Dollc, Gremnik, Novosellë e Zajmit, Grabanicë, Drenoc, Potërq i Poshtëm, Potërq i Epërm të Komunës së Klinës, dhe zonat kadastrale Jabllanicë, Kliqinë, Leshan, Gllaviqicë dhe Ramun të Komunës së Pejës", sipas tabelave të Vendimit të Qeverisë Nr. 10/115 i datës 17.12.2019.
2. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPHI, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara të vendimit qeveritar Nr. 10/115 i datës 17.12.2019.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: "Organi Shpronësues") me datë 17.12.2019, kishte nxjerrë vendimin përfundimtar për shpronësimin për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i Autostradës Prishtinë - Pejë, Segmenti Kijevë - Klinë - Zahaq, zonat kadastrale Çabiq, Zabërgjë, Gllarevë, Gjurgjevik, Dresnik, Dollc, Gremnik, Novosellë e Zajmit, Grabanicë, Drenoc, Potërq i Poshtëm, Potërq i Epërm të Komunës së Klinës, dhe zonat kadastrale Jabllanicë, Kliqinë, Leshan, Gllaviqicë dhe Ramun të Komunës së Pejës" sipas tabelave të Vendimit të Qeverisë Nr. 10/115 të datës 17.12.2019 (në tekstin e mëtejme "Objekti i Shpronësimit").

Objekti i Shpronësimit iu nënshtrua procesit të auditimit, më konkretisht vlerësimit të funksionimit të kontrollit të brendshëm ku janë evidentuar një mori parregullsish në procesin e shpronësimit, e si rezultat raporti i auditimit e cilësoi procesin e shpronësimit si shqetësim të konsiderueshëm.

Parregullsitë e asocuara me procesin e shpronësimit lidhur me Objektin e Shpronësimit, në formë të përmbledhur, duke përfshirë por duke mos u kufizuar, konsistojnë në elementet si në vijim:


- Vendimi Nr. 10/115 i datës 17.12.2019 ishte publikuar pa çmime në faqen zyrtare;
- Janë përgatitur dy tabela financiare me çmime të ndryshme. Tabelat e marra nga Organi Shpronësues janë çmime më të larta se sa ato të prezantuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme; dhe
- Akt-vlerësimet janë përpunuar duke mos i respektuar kriteret e Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 për Miratimin e Metodave dhe Kritereve Teknike të Vlerësimit për Përlogaritjen e Shumës së Kompensimit për Pronën e Paluajtshme që Shpronësohet, dhe Dëmeve që kanë të bëjnë me Shpronësimin.

Në linjë të këtyre parregullsive të evidentuara gjatë procesit të auditimit, Organi Shpronësues, ka vendosur të anuloi vendimin qeveritar Nr. 10/115 i datës 17.12.2019, mbështetur në dispozitat ligjore të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më konkretisht, nenit 54, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2.

Dispozita e sipër cekur thekson se një akt administrativ duhet anuluar nëse objekti i tij është ligjërisht apo materialisht i pamundur. Në rastin konkret, Objekti i Shpronësimit është ligjërisht dhe materialisht i pamundur për ekzekutim sepse ekzistojnë dy tabela të çmimeve të cilat kanë diskrepancë të konsiderueshme me njëra tjetrën, dhe asnjëra nuk prevalon mbi njëra tjetrën.

Nisur nga kjo situatë, mbetet materialisht dhe ligjërisht e pamundur për Organin Shpronësues të vazhdoj me ekzekutimin e vendimit shpronësues 10/115 i datës 17.12.2019 lidhur me Objektin e Shpronësimit pa e pasur një çmim referues të qartë të kompensimit. Për më tepër, vendimi shpronësues 10/115 i datës 17.12.2019 është përpiluar me të meta të cilat u përmbledhën si më lartë, të cilat nuk mund të mënjanojnë pa anulimin e tij paraprak. Si rrjedhojë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/42

Datë: 27.10.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës zbaton sanksionet e vendosura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës konform Rezolutës 1373 të Këshillit të Sigurimit të OKB-ës për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare ndaj shtatë (7) individëve të lidhur me Hezbollah dhe kompaninë AlDar Properties, për të parandaluar financimin e akteve terroriste dhe për të ngrirë pasuritë financiare të organizatës terroriste Hezbollah ose mbështetësve të saj në Republikën e Kosovës.
2. Sanksionet e lartshënuara konsistojnë në:
 - 2.1. Ngritje të aseteve në Republikën e Kosovës për individët dhe entitetin e sanksionuar;
 - 2.2. Ndalim të udhëtimit për individët e sanksionuar; dhe
 - 2.3. Ndalim për individë dhe entitete në Republikën e Kosovës, që të vënë në dispozicion fonde, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte, për individët dhe entitetin e sanksionuar.
3. Emrat e individëve dhe entitetit ndaj të cilëve zbatohen sanksionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të përcaktuara si në pikën 2. të këtij vendimi, janë të listuara në Shtojcën nr. 1, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Sanksionet do të jenë në fuqi deri në një vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen.
5. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

SHTOJCA Nr. 1

Qeveria e Republikës së Kosovës zbaton sanksionet e vendosura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, konform Rezolutës 1373 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare, ndaj shtatë (7) individëve të lidhur me Hezbollah dhe kompaninë AlDar Properties, për të parandaluar financimin e akteve terroriste dhe për të ngrirë pasuritë financiare të terroristëve të Organizatës terroriste Hezbollah-ut ose mbështetësve të saj në Republikën e Kosovës.

1. Individët:

1.1 Emri: Ali Reda Hassan al-Banai

Përshkrimi i rastit: Ali Reda Hassan al-Banai, është shpallur si terroristë global, sipas plotësimit të Urdhërit Ekzekutiv (E.O) 13224, për ofrimin e mbështetjes materiale, financiare, teknologjike, të mirave materiale ose shërbimeve për ose në mbështetje të organizatës Hezbollah;

1.2 Emri: Ali Red al-Qassabi Lari

Përshkrimi i rastit: Ali Red al-Qassabi Lari, është shpallur si terroristë global, sipas plotësimit të Urdhërit Ekzekutiv (E.O) 13224, për ofrimin e mbështetjes materiale, financiare, teknologjike, të mirave materiale ose shërbimeve për ose në mbështetje të organizatës Hezbollah;

1.3 Emri: Abd al-Muayyid al-Banai

Përshkrimi i rastit: Abd al-Muayyid al-Banai, është shpallur si terroristë global, sipas plotësimit të Urdhërit Ekzekutiv (E.O) 13224, për ofrimin e mbështetjes materiale, financiare, teknologjike, të mirave materiale ose shërbimeve për ose në mbështetje të organizatës Hezbollah;

1.4 Emri: Abd al-Rahman Abd-al-Nabi Shams

Përshkrimi i rastit: Abd al-Rahman Abd-al-Nabi Shams, është shpallur si terroristë global, sipas plotësimit të Urdhërit Ekzekutiv (E.O) 13224, për ofrimin e mbështetjes materiale, financiare, teknologjike, të mirave materiale ose shërbimeve për ose në mbështetje të organizatës Hezbollah;

1.5 Emri: Yahya Muhammed al-Abd-al-Muhsin

Përshkrimi i rastit: Yahya Muhammed al-Abd-al-Muhsin, është shpallur si terroristë global, sipas plotësimit të Urdhërit Ekzekutiv (E.O) 13224, për ofrimin e mbështetjes materiale, financiare, teknologjike, të mirave materiale ose shërbimeve për ose në mbështetje të organizatës Hezbollah;

1.6 Emri: Majdi Fa'iz al-Ustadz

Përshkrimi i rastit: Majdi Fa'iz al-Ustadz, është shpallur si terroristë global, sipas plotësimit të Urdhërit Ekzekutiv (E.O) 13224, për ofrimin e mbështetjes materiale, financiare, teknologjike, të mirave materiale ose shërbimeve për ose në mbështetje të organizatës Hezbollah;

1.7 Emri: Sulaiman al-Banai

Përshkrimi i rastit: Sulaiman al-Banai, është shpallur si terroristë global, sipas plotësimit të Urdhrit Ekzekutiv (E.O) 13224, për ofrimin e mbështetjes materiale, financiare, teknologjike, të mirave materiale ose shërbimeve për ose në mbështetje të organizatës Hezbollah.

2. Entiteteti:

2.1 Emri entitetit: AlDar Properties

Përshkrimi i rastit: AlDar Properties është shpallur si e udhëhequr, kontrolluar apo e drejtuar, direkt ose indirekt nga Sulaiman al-Banai.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/42

Datë: 27.10.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 të Ligji Nr.04/L-198 për Tregtinë me Mallra Strategjike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet përditësimi i Listës Shtetërore Strategjike për Mallra me Përdorim të Dyfishtë, duke iu referuar Listës së Bashkimit Evropian, për mallrat që vihen nën kontroll për shkaqe të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, sigurisë publike ose për arsye të të drejtave të njeriut, në përputhje me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2020/174 të datës 7 tetor 2020 për ndryshimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 428/2009 për përcaktimin e një regjimi të Komunitetit për kontrollin e eksporteve, transferimit, brokerimit dhe transitimit të artikujve me përdorim të dyfishtë.
2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatim të këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/42
Datë: 27.10.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, si dhe nenin 4 të Memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut të datës 16.09.2021, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për vlerësimin e studimit të fizibilitetit për rrugën Prizren –Tetovë.
2. Përfaqësuesit e Komisioni të Qeverisë së Republikës së Kosovës, janë:
 - 2.1. Hysen Durmishi, Zëvendësministër MMPHI, Kryesues;
 - 2.2. Ardian Begaj, Departamenti për Infrastrukturë Rrugore, anëtar;
 - 2.3. Gezime Grajqevci, Departamenti i Planifikimit Hapësinor, anëtare;
 - 2.4. Faik Kelmendi, Agjencia Kadastrale e Kosovës, anëtar.
3. Komisioni në bashkëpunim me Komisionin nga Maqedonia e Veriut, do të bëjnë vlerësimin e fizibilitetit bashkërisht me Komisionin nga Maqedonia e Veriut dhe do të nxjerrin përfundimet dhe rekomandimet përfundimtare lidhur me projektin në fjalë.
4. Sipas nevojave të punës dhe realizimin e obligimeve të parapara me këtë vendim, Komisioni mund të ftoj anëtarë të Kabinetit të Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe ekspertë dhe njohës të fushës të caktuar me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe rezultimit sa më kualitativ të punës së Komisionit.
5. Komisioni punon sipas planit të punës i cili miratohet me pajtimin në mes të dy Komisioneve.
6. Komisioni është i obliguar që për punën e tij t'i raporton Kryeministrit/Qeverisë kurdo që kërkohet raport për ecurinë e punës.
7. Obligohen anëtarët e Komisioni që të veprojnë konform memorandumit të nënshkruar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe dispozitave ligjore në fuqi të dy shteteve.

8. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Qeverisë së Maqedonisë së Veriut
- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/42

Datë: 27.10.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, si dhe nenin 4 të Memorandumit të Bashkëpunimit e lidhur ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut të datës 16.09.202, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për përgatitjen e një parallogarie/ose plani ideor për zbatimin e rehabilitimit të zonës tampon të Hanit të Elezit ndërmjet dy objekteve kufitare të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut.
2. Përfaqësuesit e Komisioni të Qeverisë së Republikës së Kosovës janë:
 - 2.1. Hysen Durmishi, Zëvendësministër MMPHI, Kryesues;
 - 2.2. Ardian Begaj, Departamenti për Infrastrukturë Rrugore, anëtar;
 - 2.3. Gezime Grajqevci, Departamenti i Planifikimit Hapësinor, anëtar;
 - 2.4. Faik Kelmendi, Agjencia Kadastrale e Kosovës, anëtar.
3. Komisioni në bashkëpunim me Komisionin nga Maqedonia e Veriut, do të bëjnë përlllogaritjen ose përgatitjen e planit ideor për zbatimin e rehabilitimit të zonës tampon të Hanit të Elezit ndërmjet dy objekteve kufitare të dy shteteve dhe do të nxjerrin përfundimet dhe rekomandimet përfundimtare në suaza të fondeve të disponueshme lidhur me projektin në fjalë.
4. Sipas nevojave të punës dhe realizimin e obligimeve të parapara me këtë vendim, Komisioni mund të ftoj anëtarë të Kabinetit të Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe ekspertë dhe njohës të fushës të caktuar me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe rezultimit sa më kualitativ të punës së Komisionit.
5. Komisioni punon sipas planit të punës i cili miratohet me pajtimin në mes të dy Komisioneve.
6. Komisioni është i obliguar që për punën e tij t'i raporton Kryeministrit/Qeverisë kurdo që kërkohet raport për ecurinë e punës.
7. Obligohen anëtarët e Komisioni që të veprojnë konform memorandumit të nënshkruar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe dispozitave ligjore në fuqi të dy shteteve.

8. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Qeverisë së Maqedonisë së Veriut
- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/42

Datë: 27.10.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 16 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për kursime dhe ndarje buxhetore në kategoritë e shpenzimeve, sipas tabelave të bashkangjitura në aneksin A (Kursimet) dhe B (Ndarjet), bazuar në kërkesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme.
2. Aprovohet pagesa e Orëve shtesë të grumbulluara mbi normë për Policinë e Kosovës deri në vlerë prej 2,215,505 € (dy milionë e dyqindpesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pese euro), mjete këto të siguruar sipas ndarjes buxhetore në pikën 1. dhe Aneksin B të këtij vendimi.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Aneks A (Kursimet)

BILLOKU_KODUES	ORGANIZATA	PROGRAMI	PROJ	PROJEKTI	Shuma
10/214/20900/13/00000/1070	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	RIINTEGRIMI I PERSONAVE TE RIATDHESUAR	13	MALLRA DHE SHERBIME	150,000
Total mallra dhe sherbime					150,000
10/214/20900/20/00000/1070	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	RIINTEGRIMI I PERSONAVE TE RIATDHESUAR	20	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	350,000
Total subvencione dhe transfer					350,000
10/214/20900/14/00000/1070	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	RIINTEGRIMI I PERSONAVE TE RIATDHESUAR	14	SHPENZIME KOMUNALE	93,000
Total shpenzime komunale					93,000
10/214/12300/30/10012/0133	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE POLITIKAVE IM	10012	KOMPLEKSI I RI QEVERITAR, NE HAUVALI NE AFERESI TE PRISHTINES	83,000
10/214/12300/30/12806/0111	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE POLITIKAVE IM	12806	NDERTIMI OBJEKTIT TE KPM	149,000
10/214/12300/30/13252/0330	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE POLITIKAVE IM	13252	DIZAJNIMI DHE NDERTIMI I OBJEKTIT GJYKATES THEMELORE NE PEJE	50,000
10/214/12300/30/13478/0930	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE POLITIKAVE IM	13478	NDERTIMI I SHKOLLES SE MUZIKES NE PRIZREN	400,000
10/214/12300/30/13550/0330	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE POLITIKAVE IM	13550	DIZAJNIMI DHE NDERTIMI I OBJEKTIT GJYKATES THEMELORE DEGA NE NOVO	125,000
10/214/12300/30/14031/0912	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE POLITIKAVE IM	14031	NDERTIMI I SHKOLLES FILORE NE BAJOINE, PODUJEVE	85,000
10/214/12300/30/14780/0912	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE POLITIKAVE IM	14780	NDERTIMI I SHKOLLES FILORE NE POZHORAN-VITI	150,000
10/214/12300/30/15415/0921	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE POLITIKAVE IM	15415	SHKOLLE E CIKUT TE ULET NE FUSHITCE TE EPERNJE - DRENAS	160,000
10/214/12300/30/15417/0921	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE POLITIKAVE IM	15417	NDERTIMI I SHKOLLES SE MESME PROFESIONALE NE KOMORAN, DRENAS	400,000
10/214/12300/30/15715/0474	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE POLITIKAVE IM	15715	NDERTIMI I NDERTESES PER ZYREN E PRESIDENCES	500,000
10/214/12600/30/18007/0970	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE POLITIKAVE IM	18007	NDERTIMI I NDERTESES PER ZYREN E PRESIDENCES	600,000
10/214/12600/30/12658/0133	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	AGJENSIONI I SHOCERISE SE INFORMACIONIT	12658	INTEROPERABILITETI	200,000
10/214/14800/30/12201/0160	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	AGJENSIONI I REGJISTRIMIT CIVIL	12201	KRIMI I ARKIVES ELEKTRONIKE	212,752
10/214/14800/30/12815/0133	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	AGJENSIONI I REGJISTRIMIT CIVIL	12815	INVENTARIZIMI DHE RENOVIMI I E QANAVE DHE SHITIMET OPERATIVE	500,000
10/214/30400/30/14601/0310	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	SHERBIMET E MBESHETJES	14601	VUSHTRRI,SKENDERAJ,DECAN SI DHE QENDRA TJERA	401,000
10/214/91500/30/14330/0950	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	AKADEMIA E KOSOVES PER SIGURI PUBLIKE	14330	BLER,AUTOM,NEVOJA,AKSP	129,167
Total shpenzimet kapitale					4,144,919
Total Kursimet					4,737,919

Aneks B (Ndarjet)

BLOKU_KODUES	ORGANIZATA	PROGRAMI	PROJ	PROJEKTI	Ndarja
10/214/30000/11/00000/0310	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	Policia e Kosoves-SHERBIJET ADMINISTRATIVE	11	PAGA DHE MEDITJE	2,215,505
Total paga dhe medite					2,215,505
10/214/14800/13/00000/0160	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	Ajencioni I Refjistrimit Civil	13	MALLRA DHE SHERBIME	719,752
10/214/30400/13/00000/0310	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	Policia e Kosoves	13	MALLRA DHE SHERBIME	1,552,000
Total mallra dhe sherbime					2,271,752
10/214/12300/30/12992/0133	MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME	DEPARTAMENTI I STANDARDEVE DHE POLITIKAVE IM	12992	RENOVIMI I OBJEKTEVE QEVERITARE	250,662
Total shpenzime kapitale					250,662
Total ndarjet					4,737,919